

**Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete**

**Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor**

**PËRDORIMI I PARABURGIMIT NË PROCEDURAT PENALE NË  
KOSOVË: SHQYRTIM DHE ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE E  
BRENGAVE TË MBETURA**

**– Pjesa II –**

**Mars, 2010**

## Tabela e Përmbajtjeve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	- 2 -
I. HYRJE.....	- 3 -
II. ARSYETIMI I VENDIMEVE MBI CAKTIMIN E PARABURGIMIT.....	- 3 -
A. Mungesa e përgjithshme e referencës ndaj fakteve .....	- 4 -
B. “Dyshimi i bazuar” .....	- 5 -
C. Tri “bazat për paraburgim” .....	- 8 -
1. Rreziku i ikjes .....	- 9 -
2. Rreziku i prishjes së provave .....	- 12 -
3. Rreziku i përsëritjes së veprës penale .....	- 14 -
D. Paraburgimi i caktuar mbi baza të paqëndrueshme.....	- 15 -
III. ARSYETIMI I VENDIMEVE PËR ZGJATJEN E PARABURGIMIT .....	- 16 -
IV. ARSYETIMI I VENDIMIT PËR APLIKIMIN E ARRESTIT SHTËPIAK .....	- 17 -
V. PËRDORIMI I MASAVE ALTERNATIVE.....	- 19 -
VI. KONKLUZIM.....	- 22 -
VII. REKOMANDIME.....	- 22 -

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport analizon arsyetimet e vendimeve mbi caktimin e paraburgimit që i nxjerrin gjykatat në Kosovë. Ai paraqitet si një shtesë e Raportit “*Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: Shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e çështjeve të mbetura (Pjesa I)*”<sup>1</sup> të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE) dhe do të duhej të lexohet në lidhje me të. Njëlloj sikur ky i fundit, ky raport bazohet në monitorimin dhe analizimin e drejtpërdrejt të 125 lëndëve ku përfshihej procedura e paraburgimit në gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë gjatë një periudhe prej 9 muajve.<sup>2</sup> Raporti shqyrton hollësisht standardet ndërkombëtare dhe praktikën në Kosovë në lidhje me arsyetimet e vendimeve të gjykatave mbi caktimin e paraburgimit fillestar, vazhdimin e paraburgimit dhe arrestin shtëpiak, si dhe përdorimin e masave alternative ndaj paraburgimit. Përmes monitorimit të drejtpërdrejt të procedurave të paraburgimit dhe dokumenteve gjegjëse të gjykatave, OSBE-ja gjeti që shumica dërmuese e vendimeve mbi caktimin e paraburgimit që i nxjerrin gjykatat në Kosovë ende përmbajnë arsytetime të pamjaftueshme, duke mos i përmbushur në këtë mënyrë standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore.

Si ligji ndërkombëtar, ashtu edhe ai vendor, parashohin që paraburgimi do të duhet të urdhërohet nga gjykata vetëm atëherë kur është patjetër i nevojshëm dhe përmes vendimit që përmban arsyetim përkatës dhe të mjaftueshëm. Përkundër kërkesave të tilla të qarta ligjore, paraburgimi në Kosovë vazhdon të urdhërohet shpeshherë kur faktet e lëndës ndoshta nuk e lejojnë një masë të tillë restriktive, dhe shumica e vendimeve të gjykatave me të cilat caktohet paraburgimi përmbajnë arsytetime të pamjaftueshme dhe abstrakte. Përdorimi i tillë i paraburgimit në procedurë penale e shkel të drejtën e të pandehurit për liri, një e drejtë që është “në rangun e parë të të drejtave themelore që e mbrojnë sigurinë fizike të një personi”.<sup>3</sup>

Kështu, përkundër asaj që është e mbrojtur mirë në ligjin ndërkombëtar dhe vendor, e drejta për liri ende nuk mbrohet sa duhet në praktikë në Kosovë. Për këtë arsye, OSBE-ja përsërit atë që faktorët institucionalë të përfshirë në procedura të paraburgimit, në veçanti prokurorët publikë dhe gjyqtarët, do të duhej të jenë më vigjilent në mbrojtjen e të drejtës për liri dhe do të duhej ta përdorin paraburgimin vetëm atëherë kur është patjetër i nevojshëm, si dhe në pajtim të plotë me kërkesat e caktuara me ligj.

---

<sup>1</sup> Ky raport është në dispozicion në faqen e internetit të OSBE-së:  
[http://www.osce.org/documents/mik/2009/12/41722\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2009/12/41722_sq.pdf)

<sup>2</sup> Periudha kryesore për të cilën raportohet është 1 janar – 30 shtator 2008, por raporti gjithashtu analizon lëndët dhe situatat që kanë ndodhur pas kësaj periudhe për aq sa ato ngritin çështje ligjore që janë të rëndësishme në masë të mjaftueshme, apo brenga lidhur me të drejtat e njeriu që janë veçanërisht serioze.

<sup>3</sup> Shih, *inter alia*, *Musuc kundër Moldavisë* Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), Aktgjykimi i 6 nëntorit 2007, paragrafi 37.

## I. HYRJE

OSBE-ja ka raportuar në të kaluarën për arsyetimet joadekuate të vendimeve mbi caktimin e paraburgimit.<sup>4</sup> Në raportet e saj të mëparshme, OSBE-ja me shqetësim ka nënvizuar arsyetimin e dobët të vendimeve mbi paraburgimin, si atij fillestar ashtu edhe për vazhdimin e tij, përkundër dispozitave të qarta ligjore që kërkojnë arsyetim të plotë.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) ka theksuar vazhdimisht që “arsyet për çfarëdo periudhe të paraburgimit, sado e shkurtër që të jetë, duhet të tregohen bindshëm nga ana e autoriteteve.”<sup>5</sup> Vendimet mbi paraburgimin nuk duhet të jenë patjetër të gjata; mund të mjaftojë edhe arsyetimi i shkurtër, përderisa i përmban bazat përkatëse dhe të mjaftueshme.<sup>6</sup>

Kërkesa për vendime të arsyetuara mirë shërben si mbrojtje e lirisë individuale dhe synon t’i mbrojë individët nga privimet arbitrare të lirisë nga ana e autoriteteve. GjEDNj ka theksuar vazhdimisht që gjykatat “duhet t’i shqyrtojnë të gjitha faktet që përkrahin apo kundërshtojnë ekzistimin e një interesi publik që e arsyeton, me gjithë respektimin e duhur të parimit të prezumimit të pafajësisë, ndonjë ikje nga rregulli i respektimit të lirisë individuale dhe që këto fakte t’i paraqesin në vendimet e tyre mbi kërkesat për lirim.”<sup>7</sup> Prandaj, arsyet për çfarëdo periudhe të paraburgimit, sado e shkurtër që të jetë, duhet të tregohen bindshëm nga ana e autoriteteve.<sup>8</sup> Vendimet e arsyetuara siç duhet, gjithashtu shërbejnë për t’u treguar palëve që ato janë dëgjuar; ua japin palëve mundësinë që të parashtrajnë ankesë kundër këtyre vendimeve, si dhe mundësinë që ai të shqyrtohet nga organ për ankesa, si dhe përfundimisht garantojnë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë.<sup>9</sup>

Gjatë katër viteve të fundit, OSBE-ja ka vërejtur vetëm përmirësime të kufizuara në arsyetimet e vendimeve mbi paraburgimin të lëshuara nga gjykatat në Kosovë. Në shumicën dërmuese të lëndëve të monitoruara, gjyqtarët në Kosovë dështuan t’i arsyetojnë si duhet vendimet mbi caktimin e paraburgimit, duke mos i përmbushur me këtë rast standardet ligjore të caktuara në ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

## II. ARSYETIMI I VENDIMEVE MBI CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Për një shqyrtim gjithëpërfshirës të vendimeve gjyqësore mbi paraburgimin, ky kapitull e zberthen analizën në disa pjesë: mungesën e përgjithshme të referimit në fakte, elementin

---

<sup>4</sup> Shih Shqyrtimin e Sistemit të Drejtësisë Penale të OSBE-së, (prill 2003 – tetor 2004): Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi (tetor, 2004), faqe 32; shih Shqyrtimin të Sistemit të Drejtësisë Penale të OSBE-së (1999-2005): Reformat dhe Shqetësimet e Mbetura (mars, 2006), faqe 52.

<sup>5</sup> Shih *Belchev kundër Bullgarisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 8 prillit 2004, paragrafi 82.

<sup>6</sup> Shih *Nikolov kundër Bullgarisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 30 janarit 2003, paragrafi 69.

<sup>7</sup> Shih *Letellier kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 qershorit, 1991, paragrafi 35.

<sup>8</sup> Shih *Belchev kundër Bullgarisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 8 prillit 2004, paragrafi 82.

<sup>9</sup> Shih *Suominen kundër Finlandës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, paragrafi 37.

e “dyshimit të bazuar” dhe tri bazat për paraburgim (rreziku i ikjes, rreziku i prishjes së provave dhe rreziku i përsëritjes së veprës penale).

### A. Mungesa e përgjithshme e referimit në fakteve

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kërkojnë nga gjykatat që ato të ofrojnë arsye të hollësishme dhe të mjaftueshme në vendimet e tyre.<sup>10</sup> Një vendim i arsyetuar duhet ta zbatojë ligjin sipas fakteve specifike të lëndës dhe nuk duhet të jetë “i përgjithësuar apo abstrakt.”<sup>11</sup> Arsyetimi adekuat i vendimit mbi caktimin e paraburgimit është i nevojshëm për të pandehurit për ta ushtruar të drejtën e tyre për ta kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit përmes ankesës<sup>12</sup> ose një kërkesë *habeas corpus*.<sup>13</sup>

Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës (KPPPK) kërkon nga gjykata që, kur të caktojë paraburgim, të japë “arsyetimin e fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar paraburgimin, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar që se personi ka kryer vepër penale, dhe faktet vendimtare nga neni 281 [...]”<sup>14</sup>

Kështu, si rregull i përgjithshëm, ligji kërkon që gjykatat t’u referohen fakteve specifike të lëndës që e lejojnë paraburgimin. Në të kundërtën, një arsyetim që vetëm i formulon arsyet për paraburgim në mënyrë abstrakte (p.sh. duke i cituar dispozitat përkatëse të kodit) nuk i përmbush qartas kërkesat e ligjit vendor dhe ndërkombëtar; një arsyetim i tillë e shkel të drejtën e të pandehurit për liri dhe do të duhej të shkojë në ankesë.

OSBE-ja vërejtë që në shumicën e lëndëve të monitoruara, gjykatat ofruan pak ose aspak arsye për ta treguar nevojën për caktimin e paraburgimit. Në shumë lëndë, gjykatat përdorën formulime të standardizuara dhe stereotype dhe nuk iu referuan fakteve të veçanta të lëndës, duke dështuar kështu që të ofrojnë një sqarim për rrethanat specifike të lëndës që e lejojnë privimin e lirisë së të pandehurit. Në fakt, duket që gjykatat shpeshherë vetëm i aprovojnë automatikisht kërkesat e prokurorëve për caktim të masës së paraburgimit, që zakonisht janë njëlloj të arsyetuara në mënyrë të dobët.<sup>15</sup>

<sup>10</sup> Shih, për shembull, lëndën *Smirnova kundër Rusisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 24 tetorit 2003, paragrafët . Gjykata gjeti që paraburgimi i aplikuesve gjatë hetimeve kishte përbërë shkelje të nenit 5 të KEDNj-së pasi që vendimet që i kishte nxjerrë gjykata ishin “tejet të shkurtra” dhe “nuk i përshkruanin hollësisht karakteristikat e situatës së aplikuesve”. (paragrafët 70-71)

<sup>11</sup> *Ibidem*, paragrafi 63.

<sup>12</sup> Shih nenin 283(3) të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (KPPPK), të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26 më 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese.

<sup>13</sup> Shih nenin 286(2),(3) të KPPPK-së.

<sup>14</sup> Shih nenin 283(1) të KPPPK-së. Për më tepër, sipas Qarkores së drejtësisë nr. 2000/27, të datës 19 dhjetor, të gjitha paraburgimet duhet të caktohen me vendim me shkrim të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe ku janë përshkruar hollësisht bazat e paraburgimit dhe provat në përkrahje të këtyre bazave. Gjyqtarët e procedurës paraprake gjithashtu duhet t’i ofrojnë arsye përse nuk janë të mjaftueshme masat alternative ndaj paraburgimit. (shih nenin 281(1)3 të KPPPK-së). KPPPK-ja u shpall me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25 më 6 korrik 2003, dhe u ndryshua më vonë.

<sup>15</sup> Për një analizë të hollësishme të arsyeve të kërkesave të prokurorëve publik për caktim të masës së paraburgimit, shih faqet 7-10 të Raportit “Përdorimi i paraburgimit në procedurat penale në Kosovë: shqyrtim dhe analizë gjithëpërfshirëse e brengave të mbetura (Pjesa 1)” të OSBE-së.

Një arsyetim tipik për caktimin e paraburgimit është paraqitur në shembullin në vijim që ka të bëjë me një urdhër për paraburgim që gjykata e qarkut në Prishtinë/Priština e lëshoi në maj të vitit 2008:<sup>16</sup>

“Sipas vlerësimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kërkesa e prokurorit publik për caktim të masës së paraburgimit është e bazuar sepse ekziston rreziku që ata, po të jenë në liri, do të ikin, do ta pengojnë rrjedhën e suksesshme të procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo bashkëpjesëmarrësit; mënyra dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale, karakteristikat personale të të pandehurve dhe rrethanat tjera tregojnë që ekziston rreziku që ata do t’i përsërisin veprat penale.”<sup>17</sup>

Shembulli i mësipërm e ilustron një arsyetim qartas të pamjaftueshëm, që vetëm i referohet bazave për paraburgim të parapara me ligj pa i lidhur ato me faktet specifike të lëndës. Fatkeqësisht, “arsyetimi” i mësipërm është pasqyrë e shumicës së vendimeve mbi paraburgimin që i nxjerrin gjykatat në Kosovë.

Vendime tjera mbi paraburgimin që i shqyrtoi OSBE-ja zbuluan një mungesë edhe më të dukshme të arsytimit. Shembulli në vijim nga një vendim i gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, e tregon këtë:

“Pas deklaratave të palëve, gjyqtari i procedurës paraprake e shqyrtoi kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së paraburgimit dhe e aprovoi atë si të bazuar dhe të arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, ashtu siç parashihet në pikat (i) dhe (ii) të nenit 281(1)1(2) të KPPPK-së. Gjyqtari i procedurës paraprake gjithashtu e shqyrtoi zbatimin e masave tjera dhe gjeti që masa e paraburgimit është masa më adekuate në këtë fazë të procedurës.”

Në rastin e dytë, duket që gjykata e ka aprovuar automatikisht kërkesën e prokurorit, duke mos e dhënë as edhe një arsye të vetme përse paraburgimi është me të vërtetë i nevojshëm.

Në vazhdim është paraqitur një analizë më e hollësishme e elementeve që duhet të vërtetohen gjatë vendosjes nëse do të caktohet paraburgimi apo jo, si dhe një vlerësim i përmbushjes së këtyre kërkesave në praktikë nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë.

## **B. “Dyshimi i bazuar”**

Elementi i parë i nevojshëm për ligjshmërinë e paraburgimit është “dyshimi i bazuar” që i pandehuri ka kryer vepër penale.<sup>18</sup> KPPPK-ja thotë qartë që vendimet mbi caktimin e

<sup>16</sup> Tre të pandehurit ishin të dyshuar për kryerje të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve (neni 332 i KPPK-së-së, mashtrimit (neni 261) dhe legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë (neni 334).

<sup>17</sup> Përveç nëse thuhet ndryshe, të gjitha përkthimet në këtë raport janë jozyrtare.

<sup>18</sup> Shih nenin 281(1)1 të KPPPK-së. Neni 5(1)c i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) e lidh në mënyrë të ngjashme privimin e lirisë me “dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale”.

paraburgimit duhet të përmbajnë, mes tjerash, “arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale.”<sup>19</sup>

Koncepti i “dyshimit të bazuar” nga KPPPK-ja mund të konsiderohet si barasvlerë në ligjin vendor e konceptit “dyshim i arsyeshëm” nga KEDNJ-ja si kërkesë për ligjshmërinë e paraburgimit. Kushti që dyshimi të jetë i bazuar mbi baza të arsyeshme a përbën një pjesë esenciale të mbrojtjes ndaj arrestimeve dhe paraburgimeve arbitrare.<sup>20</sup>

Sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GjEDNJ-së, në mënyrë që një arrestim sipas dyshimit të bazuar të jetë i arsyetuar, është e nevojshme që policia të ketë gjetur prova të mjaftueshme për ta ngritur aktakuzën në momentin e arrestimit ose gjatë kohës që personi mbahet në polici.<sup>21</sup> Nuk është as e domosdoshme që një person i paraburgosur përfundimisht të akuzohet apo sillet para gjykatës, pasi që qëllimi i paraburgimit për marrje në pyetje është progresi i hetimeve penale duke e konfirmuar ose zhdukur dyshimin që përbën bazë për paraburgim.<sup>22</sup> Në të njëjtën kohë, “fakti që dyshimi konsiderohet i besueshëm nuk mjafton dhe duhet të ekzistojnë fakte apo informata që do ta bindnin një vështrues objektiv që [i pandehuri] ka mundësi të ketë kryer vepër penale. Megjithatë, çfarë mund të konsiderohet si e arsyeshme varet nga të gjitha rrethanat.”<sup>23</sup>

GjEDNJ-ja gjithashtu ka theksuar që “në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, arrestimi apo paraburgimi i një individi nuk duhet të caktohet kurrë me qëllim që ai të detyrohet ta pranojë fajin ose të dëshmojë kundër tjerëve apo për të nxjerrë fakte ose informata që mund të shërbejnë si bazë për dyshim të arsyeshëm kundër tij.”<sup>24</sup>

Këto parime të GjEDNJ-së mund të shërbejnë si udhërrëfyes gjatë synimit për ta vërtetuar ekzistimin e “dyshimit të bazuar” që një person ka kryer vepër penale, që sipas KPPPK-së është kusht primar për ligjshmërinë e paraburgimit të një të dyshuari. Kështu, gjyqtari i procedurës paraprake duhet të bindet që faktet e prezantuara nga prokurori e përkrahin një dyshim të bazuar (ose të arsyeshëm) që një i pandehur ka kryer vepër penale. Pastaj, gjyqtari duhet të ofrojë arsye relevante dhe të mjaftueshme lidhur me nevojën për paraburgim.

Në shumë raste, OSBE-ja vërejtë që gjyqtari i procedurës paraprake nuk bëri vlerësim të pavarur të “dyshimit të bazuar”, por në vend të kësaj dha një referencë të thatë në kërkesë të prokurorit publik, nganjëherë madje edhe në vendimet për fillimin e hetimeve.

Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, më 11 korrik 2008, një gjyqtar i procedurës paraprake caktoi një muaj paraburgim kundër një të pandehuri të

<sup>19</sup> Shih nenin 283(1) të KPPPK-së.

<sup>20</sup> Shih *Cebotari kundër Moldavisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007, paragrafi 48.

<sup>21</sup> Shih *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 29 nëntorit 1988, paragrafi 53.

<sup>22</sup> Shih *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 28 tetorit 1994, paragrafi 55.

<sup>23</sup> Shih *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 30 gushtit 1990, paragrafi 32. Vlen të ceket se, në këtë lëndë, gjykata gjeti që informatat që gjenden në raportin e policisë mund vetëm “ta konfirmojnë atë që [policët] të cilët e kishin kryer arrestimin kishin dyshim të vërtetë” që i pandehuri kishte qenë i përfshirë në një vepër penale.

<sup>24</sup> Shih *Cebotari kundër Moldavisë*, GjEDNJ, Aktgjykimi i 13 nëntorit 2007, paragrafi 48.

dyshuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë.<sup>25</sup> Pjesa e arsytimit që ka të bëjë me dyshimin e bazuar thotë: “gjqytari i procedurës paraprake [...] konsideron që vendimi për t’i nisur hetimet është i arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme dhe përmban prova të mjaftueshme që e arsyetojnë dyshimin e bazuar.”

Duke mos iu referuar fakteve specifike të lëndës, gjykatat dështojnë të tregojë në mënyrë bindëse se “dyshimi i bazuar” që i pandehuri e kishte kryer veprën penale, dhe se “dyshimi i bazuar” ekziston me të vërtetë në lëndën në fjalë. Neni 281(1) i KPPK-së kërkon që ky element të tregohet.

Gjithashtu, është vërejtur që disa gjyqtarë nuk e shqyrtojnë elementin e dyshimit të bazuar që një i pandehur ka kryer vepër penale pasi që të jetë konfirmuar aktakuza në atë lëndë. Një qasje e tillë është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat theksojnë që dyshimi i bazuar që një i pandehur ka kryer vepër penale është element fundamental i kontrollit të gjyqësorit mbi ligjshmërinë e paraburgimit dhe për këtë arsye duhet të vlerësohet sa herë që të vlerësohet ligjshmëria e paraburgimit, duke përfshirë këtu edhe fazën e gjykimit. Kjo gjithashtu nxit shqetësime lidhur me respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, që gjithashtu vlen pasi që të jetë konfirmuar aktakuza e deri në momentin kur shpallet aktgjykimi.

Si çështje e ndarë, por e ndërlidhur, është gjetur që personat, në disa raste të izoluara, mund të arrestohen nga policia edhe kur nuk ekziston dyshimi i bazuar që ata në të vërtetë kanë kryer vepër penale:

Më 6 mars 2008, një nxënës e incizoi me celular momentin kur policia intervenoi në një rrahje dhe i arrestoi dy persona në një shkollë në Gjakovë/Đakovica. Policët e vërejtën që ai e kishte xhiruar intervenimin, ia konfiskuan celularin dhe e ndaluan të miturin për ta marrë në pyetje. Prokurori vendosi të mos kërkojë paraburgim dhe parashtri kërkesën për anamnezë sociale, pastaj lëshoi një vendim për fillimin e procedurës përgatitore dhe një propozim për shqiptimin e masës edukative në bazë të asaj që i mituri e kishte kryer veprën penale të fotografimit dhe incizimeve tjera të paautorizuara sipas nenit 171(1) të KPPK-së. Më 5 gusht, gjykata komunale në Gjakovë/Đakovica gjeti që i mituri ishte fajtor sipas kësaj aktakuze dhe e zbatoi masën edukative disiplinore të vërejtjes së gjykatës.

Në lëndën e përshkruar më lart, autoritetet gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit i keqinterpretuan në masë të madhe veprimet e nxënësit. Incizimi i një arrestimi në rrugë apo në një ndërtesë publike (siç është shkolla) nuk përbën vepër penale në Kosovë sepse neni 171 i KPPK-së, i cituar nga prokuroria dhe gjykata, i referohet vetëm incizimeve të paautorizuara në hapësira private. Si i tillë, incizimi me video i nxënësit i intervenimit të policisë që ndodhi në hapësira publike nuk i kishte përmbushur të gjitha elementet përbërëse të veprës penale të fotografimit dhe incizimeve tjera të paautorizuara të përshkruara në nenin 171 të KPPK-së. Kjo, në anën tjetër, nënkupton që arrestimi fillestar

<sup>25</sup> Neni 147(11) në lidhje me nenin 20 të KPPK-së.



i fëmijës nga policia ishte i paligjshëm sepse mungonte dyshimi i bazuar që ai kishte kryer veprë penale.<sup>26</sup> Për të njëjtën arsye, të gjitha masat tjera të cilave u ishte nënshtruar i mituri – konfiskimi i celularit të tij nga policia, ndjekja penale, gjykimi dhe dënimi – ishin njëloj përplot padrejtësi dhe absolutisht të paligjshme.

### C. Tri “bazat për paraburgim”

Përveç vërtetimit të dyshimit të bazuar që i pandehuri ka kryer veprë penale, gjykata gjithashtu duhet të tregojë në vendimin e saj që ekziston rreziku i ikjes, prishjes së provave apo përsëritja e veprës penale.<sup>27</sup> Cilado nga këto baza është e mjaftueshme për ta lejuar paraburgimin, mirëpo gjykata duhet t’i sqarojë arsyet përse beson që i pandehuri do të ikë, prishë provat apo përsërisë veprën penale. Me fjalë tjera, një pohim i thjeshtë nuk është i mjaftueshëm për ta mbizotëruar prezumimin në favor të pafajësisë.

Megjithatë, OSBE-ja ka vërejtur që, në shumicën e lëndëve të monitoruara, gjykatat nuk dhanë arsyet adekuate për ekzistimin e një apo më shumë bazave për paraburgim.

Së pari, disa nga vendimet mbi caktimin e paraburgimit nuk i ofrojnë arsyet përse ekziston një apo më shumë baza për paraburgim, por vetëm i parafrzojnë, përsërisin apo thjeshtë u referohen formulimeve të ligjit. Ato që paraqiten në vijim mund të shërbejnë si shembuj:

Në një lëndë në gjykatën komunale në Vushtrri/Vučitrn ku përfshiheshin dy të pandehur të dyshuar për kryerje të veprës penale të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare<sup>28</sup> dhe pengimit të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare,<sup>29</sup> më 21 prill 2008, gjykata u caktoi paraburgim të pandehurve me këtë arsyetim: “Duke marrë parasysh faktin që kemi të bëjmë me veprat penale të [...], mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, ekziston rreziku që këta të fundit mund ta përsërisin veprën penale dhe të ndikojnë në dëshmitarët. Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, kolegji gjeti se janë përmbushur kërkesat ligjore për caktimin e paraburgimit nga paragrafi 1, nënparagrafi 2, pikat 1 dhe 3 të nenit 281 të KPPPK-së.”

Në një lëndë në gjykatën komunale në Prishtinë/ Priština, më 15 korrik 2008, kolegji i gjyqtarëve ia caktoi paraburgimin një të pandehuri të dyshuar për kryerje të veprës penale të vjedhjes së rëndë,<sup>30</sup> lëndimit të lehtë trupor<sup>31</sup> dhe dëmtimit të pasurisë së luajtshme.<sup>32</sup> Sipas gjyqtarëve, ekzistonin “baza ligjore për ta caktuar paraburgimin” dhe “rrethana që tregonin që nëse i pandehuri do të ishte në liri, ai do të fshehët dhe do ta pengonte rrjedhën e procedurës

<sup>26</sup> Elementi i dyshimit të bazuar që një person ka kryer veprë penale duhet të përmbushet me rastin e arrestimit nga policia, njëloj sikur me rastin e paraburgimit. Shih nenet 210, 211 dhe 212 të KPPPK-së.

<sup>27</sup> Neni 281(1)2 i KPPPK-së. Shih gjithashtu nenin 5(1)c të KEDNj-së.

<sup>28</sup> Neni 317 i KPPK-së.

<sup>29</sup> Neni 316 i KPPK-së.

<sup>30</sup> Neni 253 i KPPK-së.

<sup>31</sup> Neni 153 i KPPK-së.

<sup>32</sup> Neni 260 i KPPK-së.

penale.” Gjykata nuk dha kurrfarë sqarimi rreth asaj se cilat ishin “rrethanat” vendimtare.

Në një lëndë në gjykatën e qarkut të Prishtinës/Priština, prokurori ka parashtruar një kërkesë duke dhënë në hollësi arsyet mbi të cilat ka pasur dyshim të bazuar se gjashtë të pandehurit kanë kryer veprën penale dhe pse – po që se do të ndodheshin në liri – ata do të mund të fshehin apo ndikojnë në bashkë-kryesit e krimit të cilët ende nuk janë arrestuar. Megjithatë, në vendimin e datës 24 shtator 2008, gjyqtari i procedurës paraprake ka deklaruar se paraburgimi duhet të zbatohet për shkak se “po të ndodheshin në liri ekzistojnë rrethana të cilat paraqesin rrezikun e ikjes, që ata do të pengojnë hetimin e lëndës duke ndikuar tek bashkë-kryesit e tyre dhe dëshmitarët, kundër të cilëve ende nuk është propozuar paraburgimi apo personat tjerë të cilët mund të thirren si dëshmitarë në të ardhmen gjatë kësaj procedure penale. Paraburgimi është caktuar për shkak të peshës serioze së rastit penal dhe rrethanave në të cilat është kryer, që janë arsyet për të besuar se nëse të pandehurit do të ndodheshin në liri ata do të mund të përsërisin apo kryejnë vepra të ngjashme penale.”

Shembujt e cekur më lartë përmbajnë arsyetime të standardizuara, paragjyqese dhe përfundimisht të paqëndrueshme. Ato thjesht ri-formulojnë dispozitat ligjore të aplikueshme, pa shpjeguar zbatimin e tyre direkt për rrethanat e veçanta të rastit. Paraburgimi me të vërtetë mund të ketë qenë i domosdoshëm në këto raste por gjyqtarët, siç përcaktohet ligj, kanë dështuar të përdorin arsyetimin e hollësishëm në shpjegimet e tyre.

Secila prej këtyre tri bazave për paraburgim sipas KPPPK-së është i shpjeguar si më poshtë.

### **1. Rreziku i ikjes**

Është e kuptueshme që autoritetet e zbatimit të ligjit mund të jenë të brengosura që një i pandehur mund të përpiqet të arratiset në mënyrë që ti shmanget dënimit penal. Në fakt, rreziku që i pandehuri do të fshehët shpesh citohet si bazë për paraburgim në Kosovë. Megjithatë, në mënyrë që rreziku të vërtetohet ai duhet mbështetet në fakte të mjaftueshme dhe relevante, gjë e cila nuk ndodhë gjithmonë në praktikë.

GjEDNj ka vendosur se në mënyrë që kjo arsye të jetë e besueshme, gjykatat vendore duhet të shpjegojnë pse ekziston rreziku i ikjes dhe jo vetëm të urdhërojnë paraburgimin në “formë të fjalëve identike, të mos themi stereotipe, pa shpjeguar në asnjë mënyrë pse ekziston rreziku i ikjes” apo pse ky rrezik nuk mund të parandalohet përmes masave alternative ndaj paraburgimit.<sup>33</sup> Prandaj gjykatësi duhet me vëmendje të vlerësoj faktorët

---

<sup>33</sup> Shih *Yagci dhe Sargin kundër Turqisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 9 qershorit 1995, paragrafi 52.

tjerë, siç është situata personale dhe personaliteti i të pandehurit, dhe lidhjet e tij apo saj me territorin, nëpërmjet familjes apo punësimit.<sup>34</sup>

Rreziku i ikjes nuk mund të përcaktohet vetëm në bazë të faktit se i dyshuari nuk ka adresë të qëndrueshme të banimit,<sup>35</sup> dhe as nuk mund të bazohet mbi faktin se është e mundshme apo e lehtë për dikë të kaloj kufirin.<sup>36</sup> Në fakt, argumenti i fundit shpesh përdoret në arsyetimet e dokumenteve në lidhje me paraburgimin në Kosovë, ku prokurorët dhe gjykatësit shpesh citojnë “natyrën poroze të kufijve të Kosovës”, “kontrollin e pamjaftueshëm të kufirit në veri”, “faktin se kufijtë e Kosovës janë liberalizuar dhe mund të kalohen me një dokument të vlefshëm udhëtimi” apo edhe që “kufijtë e Kosovës janë shumë të hapur dhe lehtë kalohen gjatë sezonit veror për turistët”, si arsye për ekzistimin e rrezikut të ikjes. Në vetvete, një arsyetim i tillë, nuk është i mjaftueshëm.<sup>37</sup> Siç edhe ka vendosur GjEDNj-ja:

“Rreziku që i akuzuari të arratiset nuk rezulton vetëm sepse është e lehtë për atë të kaloj kufirin (në çdo rast, do të ishte e mjaftueshme që për këtë qëllim të kërkohet nga ai [i pandehuri] të dorëzoj pasaportën): duhet të ekzistojnë rrethana të tëra, dhe posaçërisht, dënimi i rëndë që mund të pritët apo mospëlqimi i veçantë i paraburgimit nga ana e të akuzuarit, apo edhe mungesa e lidhjeve të qëndrueshme në vend, të cilat japin arsye të supozohet që pasojat dhe rreziqet e ikjes mund t’i duken atij një e keqe më e vogël se sa burgimi i vazhdueshëm.”<sup>38</sup>

GjEDNj-ja po ashtu ka vendosur që pesha e veprës penale (dhe ashpërsia e dënimit të pritur) mund të kenë rëndësi në vërtetimin e rrezikut të ikjes, por vetëm së bashku me elementet e tjera dhe jo veçmas.<sup>39</sup> Prandaj, do të ishte e gabuar për të vërtetuar rrezikun e ikjes bazuar në faktin se i pandehuri mund të ballafaqohet me një dënim të rëndë nëse shpallet fajtor. Megjithatë, një arsyetim i tillë i paqëndrueshëm është vërejtur në shumë vendime për caktimin e paraburgimit, që ilustron edhe me shembullin vijues:

Në një lëndë ku përfshihej një i pandehur, i dyshuar për përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës,<sup>40</sup> gjykata e qarkut e Mitrovicës/Mitrovica, më 08 maj 2009, ka miratuar një vendim duke urdhëruar paraburgimin e të pandehurit për një muaj. Në pjesën e arsyetimit të vendimit, gjyqtari i procedurës paraprake ka deklaruar *inter alia* se “kushti ligjor për caktimin e paraburgimit sipas pikës (i), nën-paragrafi 2 dhe 1 i nenit 281 i KPPK qëndron, për shkak se sipas

<sup>34</sup> Shih *Tomasi kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 gushtit 1992, paragrafi 98: “rreziku i ikjes nuk mund të matet vetëm në bazë të peshës së dënimit të mundshëm; ai duhet të vlerësohet në bazë të disa faktorëve tjerë relevant të cilët, ose mund të konfirmojnë ekzistencën e rrezikut të ikjes, ose mund të duken aq të dobëta sa që nuk arsyetojnë paraburgimin në pritje të gjykimit të aktgjykimit”.

<sup>35</sup> Shih *Sulaoja kundër Estonisë*, GjEDNj-së, Aktgjykimi i 15 shkurtit 2005, paragrafi 64.

<sup>36</sup> Shih *Stögmüller kundër Austrisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, paragrafi 15.

<sup>37</sup> “Natyra poroze” e kufijve dhe kufijve administrativë të Kosovës është një problem i mirënjohur por duhet më shumë të zgjidhet nëpërmjet rritjes së patrullimeve dhe mbikëqyrjes, se sa që të përdoret si një arsyetim i gatshëm për paraburgosje të dyshuarve.

<sup>38</sup> Shih *Stögmüller kundër Austrisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, paragrafi 15.

<sup>39</sup> Shih *Muller kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 17 marsit 1997, paragrafi 43.

<sup>40</sup> Neni 340 i KPPK-së.

mendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, fakti i vetëm se pandehuri është akuzuar për një vepër të rëndë penale që parasheh dënim me burg deri në 10 vjet, tregon frikën se nëse nuk paraburgoset, ai do të arratiset apo fshehët dhe si pasojë do të pengoj rrjedhën normale të procedurës, veçanërisht tani pasi që ka kuptuar peshën e krimit sipas të cilit është akuzuar. Sipas bindjes së thellë të gjykatës dhe duke marrë parasysh faktet e ofruara nga mbrojtja që i pandehuri nuk ka të afërm që jetojnë në Serbi apo ndonjë vend tjetër, kështu që ai nuk ka vend se ku mund të arratiset, gjykata konsideron se kjo nuk është rrethanë e cila largon frikën e ikjes. Përkundrazi, i pandehuri mund të fshehët apo arratiset kudo për t'i ikur ndjekjes penale. Prandaj, kushtet për të urdhëruar caktimin e paraburgimit sipas pikave të lartpërmendura janë të përmbushura.”

Siç është theksuar edhe më herët, rreziku i ikjes nuk mund të matet vetëm në bazë të rrezikut të peshës së dënimit. Pesha e dënimit është e rëndësishme por e pamjaftueshme në vetvete për të vërtetuar rrezikun e ikjes së të pandehurit dhe në mënyrë që paraburgimi të arsyetohet mbi këtë bazë, elementet e tjera të rëndësishme duhet po ashtu të merren parasysh nga gjykata.

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së tregon që rreziku i ikjes mund të vërtetohet në mënyrë të arsyeshme duke aluduar në faktorë të tillë, si rastet e mëhershme në të cilat i pandehuri është përpjekur t'i shmang procedurat penale duke ikur nga vendi;<sup>41</sup> apo kur është kërkuar ekstradimi në mënyrë që të vazhdohet me procedurë;<sup>42</sup> “mospëlqimi i posaçëm për paraburgim” nga ana e të pandehurit<sup>43</sup>; apo plane të veçanta për ikje;<sup>44</sup> dhe po ashtu “karakterin e personit, moralin dhe mjetet e tij, lidhjet e tij me Shtetin në të cilin ndiqet penalisht dhe kontaktet e tij ndërkombëtare.”<sup>45</sup> Kjo listë nuk është përfundimtare; faktorët e tjerë të ngjashëm (dhe kombinimi i tyre) mund të cekën për të vërtetuar që rreziku i ikjes është mundësi reale në rrethanat e veçanta të rastit.

Në anën tjetër, faktorët që mund të vërtetojnë rrezikun e ulët apo mosekzistimin e tij përfshijnë kushtet e veçanta familjare të pandehurit;<sup>46</sup> shuma e pronës që i pandehuri do të linte pas në rast të ikjes, dhe provat e mëhershme të besueshmërisë së tij apo saj pas lirimit;<sup>47</sup> dhe ndonjë sëmundje serioze prej të cilës mund të lëngojë i pandehuri.<sup>48</sup>

<sup>41</sup> Shih *Cesky kundër Republikës Çeke*, GjEDNj, Aktgjykimi i 06 qershorit 2000, paragrafi 79.

<sup>42</sup> Shih *Punzelt kundër Republikës Çeke*, GjEDNj, Aktgjykimi i 25 prillit 2000, paragrafët 87-88.

<sup>43</sup> Shih *Stögmüller kundër Austrisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969, paragrafi 15.

<sup>44</sup> Të tilla si transferimi i fondeve në ndonjë vend tjetër dhe vizitat jashtë vendit për të krijuar lidhje të veçanta (shih *Matznetter kundër Austrisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969), apo dhënia në mirëbesim e një shume të madhe të parave një të njohuri, blerja e automjetit me letërnjoftimin e personit tjetër dhe përvetësimi i pasaportës false (shih *Cesky kundër Republikës Çeke*, GjEDNj, Aktgjykimi i 06 qershorit 2000).

<sup>45</sup> Shih *W kundër Zvicrës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 janarit 1993, paragrafi 33 duke cituar paragrafin 10 në lëndën *Neumeister kundër Austrisë*; shih po ashtu *Barfus kundër Republikës Çeke*, GjEDNj, Aktgjykimi i 01 gushtit 2000; dhe *Punzelt kundër Republikës Çeke*, GjEDNj, Aktgjykimi i 25 prillit 2000.

<sup>46</sup> Shih *Letellier kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 qershorit 1991. Parashtuesi në këtë rast ka qenë nëna e një fëmije të mitur.

<sup>47</sup> Shih *W kundër Zvicrës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 janarit 1993.

<sup>48</sup> Shih *Matznetter kundër Austrisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 10 nëntorit 1969.

Në secilën lëndë veç e veç, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të marrin parasysh cilindo prej faktorëve të lartpërmendura, nëse janë të zbatueshme, dhe pastaj të bëjnë një vlerësim të përgjithshëm nëse ekziston apo jo rreziku i ikjes.

Po ashtu, në rastet kur rreziku i ikjes është baza e vetme për paraburgim, gjykatat duhet gjithmonë të vlerësojnë nëse një masë më pak kufizuese (duke përfshirë dorëzaninë, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit të pandehurit, ndoshta e shoqëruar me obligimin për paraqitje të rregullt në polici) do të ishte e mjaftueshme për të parandaluar të pandehurin për të ikur.

## 2. Rreziku i prishjes së provave

Gati çdo hetim penal përfshin dëgjimin e dëshmitarëve dhe po ashtu mbledhjen e provave tjera. Prandaj, në çdo rast ekziston mundësia teorike që i pandehuri t'i pengojë hetimet – sidoqoftë nuk mund të supozohet se në secilin rast i pandehuri do ta bëjë një gjë të tillë. Rreziku i prishjes së provave, si të gjitha bazat tjera për paraburgim, duhet të arsyetohet mirë në lidhje me faktet konkrete që i siguron.

GjEDNj-ja ka vendosur që, edhe pse rreziku i ndikimit tek dëshmitarët apo tek të pandehurit tjerë mund të jetë i vërtetë në fillim të paraburgimit, ai mund të zvogëlohet gradualisht apo edhe zhduket në tërësi.<sup>49</sup> Po ashtu, pasi që faza hetimore të ketë përfunduar, rreziku i marrëveshjes së fshehtë ndërmjet të dyshuarve dhe dëshmitarëve normalisht konsiderohet të jetë zhdukur.<sup>50</sup>

Nga këndvështrimi statistikor, rreziku i prishjes së provave (dhe në veçanti ndikimi tek dëshmitarët) duket të jetë baza më e gjerë e përdorur për caktimin e paraburgimit në Kosovë.<sup>51</sup> Megjithatë, në shumicën e vendimeve të analizuara nga OSBE, gjykatat thjesht përmendin faktin se edhe disa dëshmitarë do të thirren, si faktorë që mbështesin rrezikun e prishjes së provave.

Në një lëndë në gjykatën komunale të Kaçanikut/Kaçanik, më 27 mars 2008, gjyqtari ka caktuar paraburgimin prej 15 ditë për një të pandehur të dyshuar për mashtrim<sup>52</sup> dhe pranimin e paarsyeshëm të dhuratave.<sup>53</sup> Gjykata ka arsyetuar vendimin e saj si më poshtë: “Duke marrë parasysh kërkesën e prokurorit publik komunal në Ferizaj/Uroševac për të caktuar paraburgimin dhe faktin se duhet të dëgjohen 4 dëshmitarë, dhe në anën tjetër nëse i pandehuri do të ishte i lirë ai do të mund të ndikonte tek ta, gjykata miraton kërkesën e prokurorit publik komunal në Ferizaj/Uroševac, kurse refuzon propozimin e të pandehurit dhe avokatit mbrojtës për të caktuar masën e arrestit shtëpiak.” Vendimi që u morr, nuk beri asnjë referencë në fakte të rastit.

<sup>49</sup> Shih *Tomasi kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 gushtit 1992, paragrafët 92-95.

<sup>50</sup> Shih *Kemmache kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 nëntorit 1991, paragrafi 54. Shih po ashtu *Muller kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 17 marsit 1997, paragrafi 40.

<sup>51</sup> Ky vlerësim është bazuar në monitorimit dhe analizën e drejtpërdrejt të OSBE-së së 125 rasteve të cilat përfshijnë paraburgimin në gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë.

<sup>52</sup> Neni 261 i KPPK-së.

<sup>53</sup> Neni 250 i KPPK-së.

Në një lëndë pranë gjykatën e qarkut në Pejë/Peć, më 11 korrik 2008, gjyqtari i procedurës paraprake ka caktuar paraburgimin për një të pandehur, i dyshuar për vrasje në tentativë<sup>54</sup> dhe posedimin apo përdorimin e paautorizuar të armëve,<sup>55</sup> sipas arsytimit vijues: “Pas deklaratave të palëve [gjykata] ka vlerësuar si të bazuar dhe mjaft të arsyeshëm propozimin e prokurorit [...]. Gjyqtari i procedurës paraprake ka arsyetuar bazën ligjore sipas pikës (ii) të dispozitës së lartpërmendur mbi faktin se nëse i pandehuri gjendet në liri ai mund të ndikoj tek dëshmitarët dhe të pengojë zhvillimin normal të procedurës penale.”

Në rastet si ato më lartë, prokurorët dhe gjyqtarët në fakt mund të jenë të shqetësuar se ekziston rreziku real që i pandehuri, nëse lihet në liri, do të pengojë rrjedhën normale të hetimeve duke u përpjekur për të ndikuar tek dëshmitarët. Sidoqoftë, për të bazuar paraburgimin mbi këtë bazë, autoritetet nuk mund të mbështeten vetëm mbi shqetësime të tilla *in abstracto* por duhet të tregojnë se ekzistojnë rrethana konkrete faktike që theksojnë rrezikun e prishjes së provave apo korrupsionit të dëshmitarëve.<sup>56</sup> Për shembull, GjEDNj-ja ka deklaruar se rreziku i ndërhyrjes në rrjedhën e drejtësisë mund të arsyetohet në veçanti në disa raste komplekse dhe ekstreme,<sup>57</sup> apo në rastet kur i pandehuri mund të ketë lidhje personale me disa prej dëshmitarëve.<sup>58</sup> Gjithashtu, duhet pasur parasysh se paraburgimi i caktuar mbi baza të tilla, në parim, duhet të përfundojë sa më shpejtë, ashtu që provat mbi të cilat është urdhëruar paraburgimi janë marrë apo siguruar.<sup>59</sup> Nevoja për të mbajtur të pandehurin në paraburgim mbi bazën e parandalimit të ndikimit të tij në rrjedhën e drejtësisë ka mundësi të zhduket pasi që të mblidhen të gjitha provat dhe hetimet të përfundojnë. Gjyqtarët në Kosovë ndonjëherë dështojnë të marrin parasysh këtë shpjegim.

Në një lëndë në gjykatën e qarkut të Prizrenit/Prizren, në lidhje me aktakuzën për shkakimin e rrezikut të përgjithshëm<sup>60</sup> dhe shmangien mashtruese nga pagesa e detyrimeve,<sup>61</sup> më 27 qershor 2008, një kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë ka shqyrtuar shkresën e prokurorit, të bashkangjitur në aktakuzën e dorëzuar, dhe ka caktuar dy muaj shtesë paraburgim me arsytimin vijues: “Kolegji penal [...] ka gjetur se ekziston dyshimi i arsyeshëm që i akuzuari ka kryer veprat penale [...]. Në anën tjetër, masa e paraburgimit i përgjigjet rrezikut të veprës penale në pajtim me aktakuzën e prokurorit publik komunal në Prizren, prandaj ekziston besimi se dyshimi i bazuar që i akuzuari mund të ndikoj tek dëshmitarët apo të

<sup>54</sup> Neni 146 dhe 20 i KPPK-së.

<sup>55</sup> Neni 328 i KPPK-së.

<sup>56</sup> Shih *Trzaska kundër Polonisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 11 korrikut 2000, paragrafët 63-66. Po ashtu, shih edhe raportin e përbashkët të Zyrës së ShBA-ve dhe OSBE-së të nëntorit 2007, *Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë; Vlerësime dhe rekomandime*.

<sup>57</sup> Shih *Wemhoff kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 17.

<sup>58</sup> Shih *Conrada kundër Italisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 24 gushtit 1998, paragrafi 61. Shih po ashtu *W kundër Zvicrës*, të cituar më lartë.

<sup>59</sup> Shih Nenin 281 (2) të KPPK-së.

<sup>60</sup> Neni 291 i KPPK-së.

<sup>61</sup> Neni 92(b) i Kodit Doganor të Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/1, 30 janar 2004.

përsërit veprën penale gjatë fazës së gjykimit, dhe kjo përmbush kushtet sipas Nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 dhe 2 pikat (ii) dhe (iii) të KPPPK.” Si shënim, propozimi i prokurorit për paraburgim, i përfshirë në aktakuzë, ishte vetëm një parafrazim i thjeshtë i ligjit.

Gjykatat duhet të mbështeten në rrezikun e ndikimit tek dëshmitarët apo pengimit të drejtësisë vetëm kur ekzistojnë rrethana konkrete që mbështesin shqetësime të tilla. Çdo herë kur bazohemi në këtë arsyetim për paraburgim, kjo duhet të mbështetet në fakte konkrete dhe jo vetëm të supozohet në mënyrë abstrakte.

### 3. Rreziku i përsëritjes së veprës penale

Rreziku se një i pandehur mund të përsëritë veprën penale, kryen një vepër në tentativë apo kryen një vepër penale të cilën ai apo ajo kanë kërcënuar se do ta kryejnë është edhe një bazë mbi të cilën mund të parashikohet paraburgimi.<sup>62</sup> Megjithatë, është interesante për t’u vërejtur se disa nga ekspertët mbi të drejtat e njeriut argumentojnë se kjo bazë e paraburgimit – d.m.th. rreziku i përsëritjes së veprës penale – nuk është lehtë i pajtueshëm me prezumimin e pafajësisë, për aq sa nënkupton që i pandehuri veç ka kryer veprën penale.<sup>63</sup>

Sa i përket rrezikut të përsëritjes së veprës penale, GjEDNj t ka gjetur se rreziku duhet të jetë bindës dhe masa duhet të jetë e përshtatshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe në veçanti historinë e kaluar dhe personalitetin e personit në fjalë.<sup>64</sup> Në të njëjtën kohë, rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk mund thjeshtë të vërtetohet në bazë të precedentëve të pacaktuar<sup>65</sup> apo dënimeve të mëhershme për veprat të cilat nuk janë të krahasueshme me natyrën e tyre apo shkallën e peshës.<sup>66</sup>

OSBE-ja ka vërejtur raste të shumta ku gjykatat thjeshtë kanë deklaruar se ekziston rreziku nga përsëritja e veprës penale, por pa dhënë arsye të bindshme që mbështesin këtë shqetësim apo nuk kanë dhënë fare arsye.

Në një lëndë në gjykatën e qarkut të Prizrenit/Prizren, më 6 qershor 2008, gjyqtari i procedurës paraprake ka caktuar paraburgimin ndaj dy të pandehurve, të dyshuar për shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm<sup>67</sup> dhe shmangien mashtroese nga pagesa e detyrimeve<sup>68</sup> bazuar në, *mes tjerash*, rrezikun e përsëritjes së veprës penale.<sup>69</sup> Për lëndatë, prokurori dhe gjyqtari i procedurës paraprake kanë arsyetuar rrezikun për përsëritjen e veprës penale në bazë të dënimit të

<sup>62</sup> Shih Nenin 5(1)c të KEDNj-së dhe Nenin 281(1)2(iii) të KPPPK.

<sup>63</sup> Shih Stefan Trechsel, *Të Drejtat e Njeriut në Procedurat Penale [Human Rights in Criminal Proceedings]* (Oxford University Press 2006), faqe 526.

<sup>64</sup> Shih *Clooth kundër Belgjikës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 12 dhjetorit 1991, paragrafi 40.

<sup>65</sup> Shih *Muller kundër Francës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 17 marsit 1997, paragrafi 44.

<sup>66</sup> Shih *Clooth kundër Belgjikës*, GjEDNj, Aktgjykimi i 12 dhjetorit 1991, paragrafi 40.

<sup>67</sup> Neni 291 i KPPK-së.

<sup>68</sup> Neni 92(b) i Kodit Doganor të Kosovës.

<sup>69</sup> Si vërejtje, në të njëjtën lëndë baza tjetër e thirrur (rreziku i prishjes së provave) ka qenë krejtësisht e paarsyetuar.

mëhershëm të pandehurit për një veprë të ngjashme penale. Në të njëjtën kohë, gjyqtari i procedurës paraprake ka dështuar për të përmendur çfarëdo arsye tjera për caktimin e paraburgimit për të pandehurin e dytë.

Duket se shumë prokurorë dhe gjyqtarë shpesh supozojnë faktin se nëse një person dyshohet se ka kryer një veprë serioze penale, kjo nënkupton se ai apo ajo mund të kryejnë një veprë tjetër penale dhe për këtë arsye duhet të mbahet në paraburgim. Rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të dëshmohet mbi fakte konkrete si personaliteti i të akuzuarit, sjellja e tij apo saj në të kaluarën dhe në veçanti nëse ka ndonjë dënim të mëhershëm për vepra të ngjashme penale.

Në përgjithësi, dhe siç është treguar në pjesët e lartpërmendura, ende ka probleme të theksuara sa i përket arsyetimit të vendimeve për caktimin e paraburgimit në Kosovë. Nevoja për caktimin e paraburgimit shpesh herë nuk vërtetohet mbi fakte konkrete dhe të mjaftueshme të rastit. Veç kësaj, ka raste kur prokurorët parashtrajnë një kërkesë të bazuar për caktimin e paraburgimit por gjyqtari i procedurës paraprake dështon që së paku të përcjell atë arsyetim.

Në një lëndë lidhur me akuzat për furnizim, transport, prodhim, këmbim ose shitje të paautorizuar të armëve<sup>70</sup> para gjykatës së qarkut të Prizrenit, prokurori publik komunal, si veprim që vlen të lëvdohet, ka paraqitur një kërkesë mirë të arsyetuar për caktimin e paraburgimit, mbi të cilën ka vërtetuar rrezikun e bazuar për përsëritjen e veprës penale në bazë të dënimeve të mëhershme të pandehurit për vepra të ngjashme penale. Megjithatë, gjyqtari i procedurës paraprake, në vendimin për caktimin e paraburgimit, ka dështuar të ofroj arsye të ngjashme dhe të mjaftueshme – përkundër faktit që detyra e tij ishte lehtësuar nga kërkesa mirë e përgatitur e prokurorit për caktimin e paraburgimit.

#### **D. Paraburgimi i caktuar mbi baza të paqëndrueshme**

Po ashtu, OSBE-ja ka vërejtur se gjyqtarët e procedurës paraprake herë pas herë bazojnë vendimet e tyre për caktimin e paraburgimit mbi baza që nuk sigurohen me ligj.

Në një lëndë lidhur me një të pandehur të dyshuar për lëndim të rëndë trupor,<sup>71</sup> më 14 maj 2008, prokurori publik komunal i Prizrenit ka parashtruar një aktakuzë e cila po ashtu ka përmbajtur kërkesën për caktimin e paraburgimit. Në të njëjtën ditë, një kolegji tri anëtarësh i gjykatës komunale të Prizrenit ka miratuar kërkesën e prokurorit dhe ka caktuar paraburgimin në kohëzgjatje prej një muaji për të pandehurin duke arsyetuar, *inter alia*, që paraburgimi ka qenë i nevojshëm “për shkak të aktakuzës të ngritur kundër tij.”

Një arsyetim i tillë për caktimin e paraburgimit jo vetëm që nuk ka bazë në ligj por është qartazi në kundërshtim me kërkesën për mbikëqyrje efikase mbi të gjitha aktet e prokurorisë, të cilat ndikojnë mbi të drejtat fundamentale të personit.

---

<sup>70</sup> Neni 327 i KPPK-së.

<sup>71</sup> Neni 154 i KPPK-së.



Gjyqtarët gjithmonë duhet, në mënyrë të pavarur, të mbikëqyrin veprimet e prokurorisë të cilat ndikojnë në parimet themelore të drejtave të njeriut dhe jo vetëm të miratojnë këto veprime.

### III. ARSYETIMI I VENDIMEVE PËR ZGJATJEN E PARABURGIMIT

KPPK-ja përmban parimin e vendosur nga GjEDNj-ja se paraburgimi “nuk duhet të zgjas më shumë se sa që është e domosdoshme”, duke përcaktuar se “çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.”<sup>72</sup>

Prandaj prokurorët kanë për obligim të zhvillojnë hetimet me kujdes të veçantë në rastet kur i pandehuri është në paraburgim.<sup>73</sup> Duhet pasur parasysh se disa nga bazat që arsyetojnë caktimin e paraburgimit, si rreziku i ndikimit tek dëshmitarët apo çfarëdo pengimi i drejtësisë, me gjithë gjasë do të zvogëlohen ndërsa prokurorët përfundojnë hetimet e tyre. Prandaj, përderisa të rritet kohëzgjatja e paraburgimit gjykatat duhet të jenë më këmbëngulëse në mbikëqyrjen e tyre të këtyre paraburgimeve.

KEDNJ-ja ka konstatuar që “[k]ëmbëngulja për dyshim të arsyeshëm që personi i arrestuar ka kryer veprën penale është një *conditio sine qua non* për ligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit, por pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore ai nuk është më i mjaftueshëm”, prandaj vazhdimi i paraburgimit duhet të arsyetohet me baza tjera “relevante dhe të mjaftueshme”.<sup>74</sup>

Si të tilla, gjatë shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e paraburgimit, gjykatat duhet ta vëzhgojnë me kujdes nevojën për vazhdim të paraburgimit me përpikëri më të madhe dhe vendimet për vazhdimin e paraburgimit duhet ta plotësojnë edhe standardin e arsyetimit që është po aq i lartë, nëse jo më i lartë se sa ai i vendimit fillestar për paraburgim.

OSBE-ja ka vërejtur se megjithatë, ky është një rast i rrallë. Në shumicën e rasteve të analizuara që përfshijnë paraburgime të vazhduara, prokurorët kanë dështuar të tregojnë se vazhdojnë të ekzistojnë bazat për paraburgim dhe se janë marrë të gjithë hapat e arsyeshëm për t’i ndërmarrë hetimet me shpejtësi.<sup>75</sup> Për shembull, prokurorët mund të paraqesin propozim që paraburgimi të vazhdohet në bazë të faktit që ata ende duhet të dëgjojnë disa dëshmitarë, duke dështuar në të njëjtën kohë të sqarojnë përse këta dëshmitarë nuk janë dëgjuar ende gjatë periudhës së konsiderueshme të kohës që i pandehuri gjendet në paraburgim. Megjithatë, shumë gjyqtarë të procedurës paraprake pranojnë kërkesa të tilla dhe miratojnë vazhdimin e paraburgimit. Përgjithësisht, gjatë

<sup>72</sup> Neni 5(3) i KPPK-së.

<sup>73</sup> Neni 285(1) i KPPK përcakton se prokurorët publik, në parashtrimin e kërkesës për zgjatjen e paraburgimit, duhet të tregojnë *inter alia* “se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar zbatimin e hetimit.” Ngjashëm, GjEDNj kërkon që autoritetet kompetente të zhvillojnë hetimet “me kujdes të veçantë” në rastet kur i pandehuri është në paraburgim. Shih *Assenov a. o. kundër Bullgarisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 28 tetorit 1998, paragrafi 154.

<sup>74</sup> Shih *Musuc kundër Moldavisë*, GjEDNj Aktgjykimi i 6 nëntorit 2007, paragrafi 39.

<sup>75</sup> Siç kërkohet nga neni 285(1) i KPPK-së.

vazhdimin të paraburgimeve, gjyqtarët shpeshherë nuk japin vështrime kritike të nevojës aktuale për vazhdim të paraburgimit dhe shpeshherë mbështeten në disa shprehje të paqarta dhe formulime të përsëritura të ligjit që janë të njëjta me ato të paraburgimit fillestar të të pandehurit.

Për më tepër, kërkesat për vendime për vazhdim të paraburgimit janë shpesh me arsytim më të mangët se sa kërkesat fillestare për paraburgim.

Në një rast pranë gjykatës komunale në Prizren, ku përfshiheshin akuza të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm,<sup>76</sup> dy të pandehur kishin qenë në paraburgim që nga fillimi i qershorit 2008. Pas ngritjes së aktakuzës, prokurori publik kishte kërkuar zgjatje të paraburgimit të të pandehurve, por pa ofruar kurrfarë arsye në mbështetje të kësaj kërkesë, si dhe pa treguar nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat për kryerjen e hetimeve me nguti. Më 27 qershor 2008, kolegji prej tre gjyqtarëve miratoi zgjatjen e paraburgimit të të pandehurve për dy muaj tjerë, thjeshtë duke parafrazuar dispozitat e nenit 281 të KPPPK-së dhe pa cituar ndonjë arsye specifike përkatëse dhe të mjaftueshme për të treguar nevojën për vazhdim të paraburgimit. Vlen të përmendet se vendimi fillestar për paraburgim në të njëjtin rast ishte shumë më mirë i arsyetuar dhe do të mund të shërbente si një shembull i gatshëm për kolegjin prej tre gjyqtarëve.

Prokurorët dhe gjyqtarët duhet ta kenë parasysh se kërkesa dhe vendimi për vazhdimin e paraburgimit duhet të arsyetohet në të njëjtën masë sikurse urdhrat fillestar, dhe duhet të përmbajë referenca të sakta të rrethanave specifike që e arsyetojnë vazhdimin e paraburgimit.

#### **IV. ARSYETIMI I VENDIMIT PËR APLIKIMIN E ARRESTIT SHTËPIAK**

Arresti shtëpiak është alternativë ndaj paraburgimit. Ndonëse është masë e veçantë dhe më pak kufizuese e lirisë së një personi në krahasim me paraburgimin, masa e arrestit shtëpiak duhet të aplikohet duke pasur parasysh të njëjtat garanci procedurale sikur te paraburgimi, përmes vendimeve që përmbajnë arsyetim relevant dhe të mjaftueshëm. Ky rregull i përgjithshëm reflektohet si në të drejtën vendore<sup>77</sup> ashtu edhe në standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.<sup>78</sup>

OSBE-ja ka vërejtur megjithatë që, kërkesat dhe vendimet për arrest shtëpiak shpesh përmbajnë arsyetim që është edhe më i dobët se sa – ndonëse edhe ky i pamjaftueshëm – arsyetimi i vendimit për caktimin e paraburgimit. Arsyet në mbështetje të shqiptimit të masës së arrestit shtëpiak janë pa ndonjë përjashtim shumë të shkurtra dhe sipërfaqësore, në mos të themi nuk ekzistonin fare.

<sup>76</sup> Neni 291i KPPK-së.

<sup>77</sup> Nenet 278(7), 281(1) dhe 283(1) i KPPPK-së, që të tria të shqyrtuara në lidhje me njëra-tjetrën.

<sup>78</sup> Sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, arresti shtëpiak përbënë privim të lirisë (shih *Vachev kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 08 korrik 2004, paragrafi 64) dhe prandaj personi në arrest shtëpiak ka të drejtë në të gjitha garancitë procedurale të parapara në nenin 5 të KEDNj-së, përfshirë atë të përmendjes së arsyeve relevante dhe të mjaftueshme në vendimin për vendosjen e tij/saj në arrest shtëpiak.

Në një rast me dy të pandehur të dyshuar për vepër penale të shtrëngimit<sup>79</sup> pranë gjykatës së qarkut në Pejë/Peć, gjyqtari i procedurës paraprake kishte refuzuar kërkesën e prokurorit për paraburgim dhe në vend të kësaj kishte vendosur që të shqiptojë arrest shtëpiak për njërin kurse paraqitje në stacionin policor për tjetrin të pandehur. Në vendimin e saj të datës 4 gusht 2008, gjykata përsëriti argumentet e palëve, pastaj konstatoi që “pas shqyrtimit të deklaratave të palëve, kishte vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, duke shpresuar që me këto masa nuk do të pengohet rrjedha e procedurës.”

Në një rast që përfshinte shtatë të pandehur të akuzuar për shpërdorim të detyrës zyrtare apo autorizimit,<sup>80</sup> moslajmërim të veprave penale apo moslajmërim të kryerësit të saj,<sup>81</sup> dhe dhënia e ryshfetit,<sup>82</sup> a gjyqtari i procedurës paraprake në Prishtinë/Priština kishte miratuar kërkesën për arrest shtëpiak kundër dy të pandehurve me vetëm këtë arsytim: “Masa e arrestit shtëpiak është shqiptuar në bazë të nenit 278 (1) alineja (1) dhe (2) e KPPK-së sepse në qoftë se lihen të lirë ekziston rreziku i arratisjes nga shtëpia, dhe të pandehurit do ta pengonin kryerjen me sukses të procedurës penale duke ndikuar në dëshmitar apo në njeri tjetrin, dhe nëse lihen të lirë ata do të mund të kryejnë vepra të ngjashme penale.”

Arsyetimi i tillë që nuk mbanë kurrfarë referimi lidhur me rrethanat specifike të rastit, është joadekuat për qëllim të arsytimit të caktimit të masës së arrestit shtëpiak, i cili kërkon ekzistimin e arsyeve relevante dhe të mjaftueshme për të treguar se ai është me të vërtetë i nevojshëm.

Vlen të përmendet që gjyqtarët e procedurës paraprake kanë tendenca që shpeshherë në vendimet e tyre të thonë se kërkesa e prokurorit për paraburgim është e pabazë dhe pastaj të aplikojnë masën e arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit – por pa sqarim të asaj se përse kjo masë e caktuar është e bazuar dhe e nevojshme.

Në një rast që përfshinte akuza për lëndim të lehtë trupor<sup>83</sup> pranë gjykatës komunale në Prizren, më 1 Gusht 2008 prokurori kishte ngritur propozim-akuzë në procedurë të shkurtër kundër të dyshuarit dhe kishte kërkuar që ai të vendosej në paraburgim për një muaj. Gjyqtari i procedurës paraprake në vendimin e vet për paraburgim kishte dhënë këtë arsytim: “Kërkesa e prokurorit publik komunal nuk është e bazuar. Në bazë të vlerësimit të propozimit të prokurorit publik komunal të Prizrenit, atë të avokatit mbrojtës dhe, në veçanti, atë të të pandehurit dhe garancive të dhëna nga ana tij që ai do t’i përgjigjet çdo thirrjeje të gjykatës apo prokurorit publik komunal në Prizren, gjykata erdhi në përfundim se arsyet në bazë të së cilave është bërë kërkesa për paraburgim nuk ekzistojnë, p.sh. është marrë në konsideratë pika

---

<sup>79</sup> Neni 267 i KPPK-së.

<sup>80</sup> Neni 339 i KPPK-së.

<sup>81</sup> Neni 304 i KPPK-së.

<sup>82</sup> Neni 344 i KPPK-së.

<sup>83</sup> Neni 153 i KPPK-së.

(iii) meqë nuk ekziston rreziku që ky i fundit do ta përsërisë veprën penale duke pasur parasysh premtimin e tij që do t'i përgjigjet çdo thirrjeje të gjykatës si dhe kur kemi parasysh seriozitetin e veprës penale meqë kjo është vepër penale e dënueshme me burgim deri në tre vjet. Prandaj, duke pasur një vlerësim të tillë të rrethanave preliminare, gjykata beson që masa e arrestit shtëpiak e siguron praninë e të akuzuarit në shqyrtimin kryesor.”

Një arsyetim i tillë është i pamjaftueshëm meqë nuk paraqet arsye relevante dhe të mjaftueshme për të treguar përse masa e arrestit shtëpiak *per se* është e nevojshme në këtë rast. Prandaj arsyetimi i gjykatës nuk arrin të plotësojë kërkesat e ligjit vendor e as të standardeve ndërkombëtare të aplikueshme, të cilat kërkojnë që një vendim për shqiptim të privimit nga liria – çka edhe është arresti shtëpiak – duhet të mbështetet me arsye relevante dhe të mjaftueshme.

## V. PËRDORIMI I MASAVE ALTERNATIVE

Paraburgimi është një masë e rëndë që nuk mund të aplikohet përveç në rastet ku është më se e nevojshme nga rrethanat specifike të rastit.

Standardet ndërkombëtare parashohin që paraburgimi është masë e fundit, që mund të aplikohet vetëm kur masat tjera (më të lehta) janë të pamjaftueshme.<sup>84</sup> Sipas GjEDNj-së “nuk është e mjaftueshme që privimi nga liria të bëhet në përputhje me të ligjin vendor; ai duhet gjithashtu të jetë i nevojshëm sipas rrethanave”<sup>85</sup> Thënë ndryshe, përveç nëse paraburgimi është absolutisht i nevojshëm duhet të përdoren masa tjera.

Ngjashëm me këtë, KPPPK-ja parashihet paraburgimin si masën më të ashpër të sigurimit të pranisë së të akuzuarit në gjykim dhe zhvillim të suksesshëm të procedurës penale. Paraburgimi nuk mund të përdoret nëse një masë më pak e ashpër do të ishte e mjaftueshme për arritjen e së njëjtit qëllim.<sup>86</sup>

KPPPK-ja parashihet një sërë masash tjera jondaluese që gjithashtu synojnë të sigurojnë praninë e të pandehurit, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprave penale dhe për të siguruar zhvillim të suksesshëm të procedurës penale. Këto masa alternative përfshijnë thirrjen, premtimin e të pandehurit për të mos e lëshuar vendbanimin aktual, ndalesat për të iu afruar ndonjë vendi apo personi, paraqitja në stacion policor dhe dorëzania.<sup>87</sup>

---

<sup>84</sup> Rregulli 6.1 i Rregullave Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Masat Jondaluese (“*Rregullat e Tokios*”) parashohin që paraburgimi të përdoret vetëm si mjet i fundit në procedurën penale duke i kushtuar vëmendje të duhur hetimeve të veprave të supozuara dhe mbrojtjes së shoqërisë dhe viktimës.” Shih gjithashtu *B. Hill. kundër Spanjës*, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, (2 prill 1997), UN doc. GAOR, A/52/40 (Vol. II), paragrafi 12.3.

<sup>85</sup> Shih *N. C. kundër Italisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 11 janar 2001, paragrafi 41.

<sup>86</sup> Neni 268(1-2) i KPPPK-së.

<sup>87</sup> Neni 268(1) i KPPPK-së

OSBE-ja ka gjetur që afërsisht tri të katërtat e vendimeve të shqyrtuara për paraburgim nuk kishin arsyetim lidhur me atë se përse masat tjera alternative ndaj paraburgimit nuk janë adekuate.<sup>88</sup> Shumica e aktgjykimeve të analizuara për paraburgim përmendin që masat tjera alternative ndaj burgimit janë jo-adekuate vetëm kalimthi dhe pa ndonjë arsye për një përcaktim të tillë, ka gjithashtu disa vendime që nuk i bëjnë kurrfarë reference masave alternative ndaj paraburgimit.

Në një rast pranë gjykatës komunale të Vushtrrisë/Vuçitrn, më 27 korrik 2007 kolegji prej tre gjyqtarëve kishte shqiptuar paraburgim me kohëzgjatje prej një muaji ndaj të pandehurit të dyshuar për lëndim të lehtë trupor.<sup>89</sup> Aktgjykimi nuk adreson saktësisht përse masat tjera janë joadekuate, dhe vetëm kishte thënë që “gjykata konsideron që paraburgimi do t’i ndihmojë rrjedhës së suksesshme të procedurës penale.”

Paraburgimi duhet të aplikohet vetëm kur është tejet e nevojshme, e jo vetëm kur ai mund t’i “ndihmojë” rrjedhës së procedurës penale. Meqë pamjaftueshmëria e masave alternative ndaj paraburgimit është parakusht për aplikimin e paraburgimit, ai duhet të arsyetohet duke iu referuar rrethanave specifike të rastit. Dështimi për ta bërë këtë, mund ta bëjë vendimin si të arsyetuar në masë të pamjaftueshme, posaçërisht nëse fillimisht nuk është marrë ndonjë fakt specifik në mbështetje të bazave për paraburgim.

Duke marr parasysh që shumë vendime për paraburgim nuk përmbajnë kurrfarë shtjellimi për alternativat ndaj paraburgimit, shpeshherë është e paqartë nëse gjykata në fakt ka marrë parasysh aplikimin e mundshëm të alternativave ndaj paraburgimit, siç kërkohet shprehimisht me nenin 281(1)3 i KPPK-së, kurdo që ka ndonjë kërkesë për paraburgim. Përderisa gjyqtarët në fakt mund të shqyrtojnë mundësinë e aplikimit të alternativave (dhe prapë të vendosin të urdhërojnë paraburgimin), nuk ka asgjë në vendimet e tyre të shkruara që tregon së alternativat ndaj paraburgimit janë marrë në konsideratë.

Në përgjithësi, prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake shpesh duket të mbështeten së tepërmi në masat më kufizuese, si paraburgimi apo arresti shtëpiak, bile edhe në rastet kur rrethanat specifike mund të tregojnë që alternativat ndaj paraburgimit do të ishin të mjaftueshme për të siguruar rrjedhë të duhur të procedurës penale.

Një problem i veçantë është identifikuar sa i përket aplikimit të dorëzarisë, si alternativë ndaj paraburgimit. Disa gjyqtarë janë shprehur që masa e dorëzarisë, si alternativë ndaj paraburgimit, nuk mund të aplikohet në rastet kur i pandehuri është i akuzuar për vepra penale për të cilat ndëshkimin i paraparë me ligj është pesë vjet dënim me burg apo më i lartë.

---

<sup>88</sup> Ky vlerësim është i bazuar në analizat nga monitorimi dhe analizimi i drejtpërdrejtë i OSBE-së i 125 rasteve që përfshinin procedura të paraburgimit pranë gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë, nga 1 janari 2008 deri 30 shtator 2008.

<sup>89</sup> Neni 153 i KPPK-së.

Në një rast me pesë të pandehur të akuzuar për vrasje të rëndë<sup>90</sup> dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve,<sup>91</sup> gjyqtari i procedurës paraprake në gjykatën e qarkut në Prizren në seancën për caktimin e paraburgimit të mbajtur më 29 shkurt 2008 kishte urdhëruar paraburgimin e tre të pandehurve dhe masën e paraqitjes në stacion policor për dy të pandehurit tjerë. Në refuzimin e propozimit për dorëzani, të parashtruar nga dy avokat mbrojtës, gjyqtari i procedurës paraprake ndër të tjera kishte dhënë arsyetimin që “Për më tepër, neni 274 paragrafi 2 nënparagrafi 2 nuk lejon fare dorëzanimin për këto vepra penale, sepse këto vepra penale janë të dënueshme me së paku pesë vite burgim.”

Një arsyetim i tillë është i pasaktë sipas KPPPK-së si dhe në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. KPPPK-ja, në parim, lejon aplikimin e dorëzanimin në të gjitha rastet ku ekziston rreziku që i pandehuri të arratiset, pavarësisht nga veprat penale për të cilat i pandehuri dyshohet apo dënimin që ai ose ajo rrezikon të marrë.<sup>92</sup> Përveç kësaj KPPPK-ja lejon në parim edhe aplikimin e dorëzanimin në rastet ku e vetmja bazë për paraburgim është rreziku që i pandehuri mund të kryej vepër të re penale, përdërisa i pandehuri nuk dyshohet për vepër penale që dënohet me burgim prej së paku pesë viteve, në kapitujt e numëruar në mënyrë shteruese në nenin 274(2)2 të KPPK-së.<sup>93</sup>

Prandaj, të thuhet që dorëzania nuk mund të aplikohet në një rast që përfshinë vepër penale të dënueshme prej së paku pesë viteve burgim, është interpretim i gabuar i ligjit. KPPPK-ja lejon aplikimin e dorëzanimin në të gjitha rastet (përfshirë ato me vepra penale që janë të dënueshme me më tepër se pesë vite burgim) ku ekziston vetëm rreziku i arratisjes (dhe jo vetëm kryerjes së veprës së re penale). Ai gjithashtu lejon aplikimin e dorëzanimin në rastet e dënueshme me më pak se pesë vite burgim edhe në rastet kur ekziston rreziku i kryerjes së veprës së re penale dhe kjo është e vetmja bazë për paraburgim; si dhe lejon gjithashtu aplikimin e dorëzanimin për veprat e dyshuara penale të dënueshme me më tepër se pesë vite burgim nëse përsëritja e veprës penale është baza e vetme për paraburgim dhe nëse ato vepra penale nuk bien nën kapitujt e përmendur për së gjëri në nenin 274(2)2 të KPPPK-së (për shembull, vepra penale e torturës,<sup>94</sup> apo ajo e rasteve të rënda të vjedhjes grabitqare apo të grabitjes,<sup>95</sup> secila është e dënueshme me më së paku pesë vite burgim, dhe asnjëra nga to nuk bien në kapitujt për të cilat neni 274(2)2 i KPPPK-së e ndalon përdorimin e dorëzanimin).

GjEDNj-ja gjithashtu ka konstatuar që si rregull i përgjithshëm, pa asnjë përjashtim, ndalimi i dorëzanimin në rastet që përfshijnë akuza serioze dhe të cilat e përjashtojnë *a priori* mundësinë e çdo konsiderate nga gjyqtari për lirim me dorëzani (siç ishte rregulli i theksuar nga gjyqtari i procedurës paraprake në rastin e cituar më lart) do ta shkelte të drejtën e personit për liri, meqë në fakt do ta hiqte kontrollin gjyqësor mbi paraburgimin

---

<sup>90</sup> Neni 147 i KPPK-së.

<sup>91</sup> Neni 328 i KPPK-së.

<sup>92</sup> Neni 274(1) i KPPK-së.

<sup>93</sup> Këto janë kapitujt XIII, XIV, XV, XIX, XX, XXV, XXVII dhe XXVIII të KPPK-së.

<sup>94</sup> Neni 165 i KPPK-së.

<sup>95</sup> Neni 256 i KPPK-së.

në atë kategori përkatëse të rasteve, në kundërshtim me nenin 5(3) të KEDNJ-së.<sup>96</sup> Prokurorët dhe gjyqtarët duhet më me kujdes të shqyrtojnë mundësinë e aplikimit të dorëzarisë si dhe alternativat tjera ndaj paraburgimit, gjatë rrjedhës së procedurës penale në pajtim të plotë me kornizën normative të vendosur nga KPPPK-ja.

## VI. KONKLUDIM

Korniza ligjore në Kosovë siguron rregulla adekuate për përdorimin e paraburgimit në procedura penale, në pajtim të plotë me standardet e aplikueshme ndërkombëtare. Mirëpo, vendimet për paraburgim të lëshuara nga gjykatat në Kosovë shpeshherë dështojnë t'i plotësojnë këto kërkesa ligjore dhe paraburgimet urdhërohen pa dhënë arsye të mjaftueshme për të dëshmuar se ai është i nevojshëm në rrethanat e rastit specifik.

Në shumë raste, organet e rendit dhe zyrtarët gjyqësorë me sa duket mbështeten së tepërmi në paraburgim, edhe në rastet kur rrethanat specifike tregojnë që masat më pak të ashpra parandaluese do të ishin të mjaftueshme. Në veçanti, kur të shqyrtohen raste ku përfshihen vepra serioze penale, shumë gjyqtarë dhe prokurorë thirren në peshën e akuzave që e rëndojnë të pandehurin dhe faktin që ai mund të arratiset, bëjë marrëveshje të fshehta ose kryej vepër të re penale, duke e bartur kështu barrën e të provuarit të i pandehuri paraburgimi është i panevojshëm.

Një qasje e tillë është qartazi në mospërputhje si me ligjin vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar. Si gjyqtarët, ashtu dhe prokurorët publik, duhet në secilin rast t'i shqyrtojnë rrethanat që shkojnë në favor dhe kundër paraburgimit, dhe të vendosin me kujdes, duke iu referuar kritereve ligjore, nëse ekzistojnë arsye të mjaftueshme relevante për të arsyetuar paraburgimin. Në veçanti, gjyqtarët duhet gjithmonë të nisen nga perspektiva që privimi i lirisë është masë e fundit, dhe ata jo vetëm që duhet të kërkojnë nga prokurorët që të paraqesin arsye të mjaftueshme për paraburgim, por duhet edhe t'iu bëjnë një kontroll të pavarur dhe kritik arsyeve të paraqitura.<sup>97</sup> Derisa është e vërtetë që vendimet për paraburgim të lëshuara nga gjykatat në Kosovë kanë shënuar një përmirësim gradual sa i përket arsyetimit ligjor në disa vitet e fundit, ky përparim mbetet mjaftë i ngadaltë. Prandaj, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të ndërmarrin hapa shtesë për të përmirësuar praktikën e tyre për sa i përket përdorimit të paraburgimit fillestar, vazhdimet të paraburgimit, dhe alternativat ndaj paraburgimit gjatë procedurave penale.

## VII. REKOMANDIME

### **Për Gjykatën Supreme të Kosovës:**

- Në kontekst të rastit specifik apo përmes një mendimi sqarues ligjor, të qartësojë dhe ritheksojë që masat e paraburgimit gjatë procedurave penale duhet gjithnjë të

<sup>96</sup> Shih *S.B.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GjEDNj i datës 19 qershor 2001, paragrafi 22.

<sup>97</sup> Shih Monica Macovei, *E Drejta për Liri dhe Siguri të Personit. Udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* (Doracaku për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës (Nr. 5), 2002), faqe 8.

urdhërohen përmes vendimeve që përmbajnë arsyetim specifik, relevant dhe të mjaftueshëm.

**Për Prokurorët publik:**

- Të kërkojnë paraburgim vetëm në rastet kur ligji dhe rrethanat specifike të rastit e kërkojnë një masë të tillë kufizuese dhe të lëshojnë kërkesa për paraburgim vetëm atëherë nëse në to përmbahen arsye relevante dhe të mjaftueshme.

**Për gjyqtarët:**

- Të caktojnë paraburgim vetëm kur rrethanat e rastit e kërkojnë një masë të tillë kufizuese.
- Të japin arsye relevante dhe të mjaftueshme në të gjitha vendimet për caktimin e paraburgimit, në përputhje me ligjin dhe praktikën vendore dhe ndërkombëtare.
- Në veçanti të citojnë provat relevante dhe rrethanat e veçanta faktike që e kërkojnë paraburgimin dhe të sqarojnë përse masat alternative ndaj paraburgimit janë të pamjaftueshme.

**Për Odën e Avokatëve të Kosovës:**

- Të udhëzojnë avokatët mbrojtës që të mbrojnë klientët e tyre në mënyrë efektive duke atakuar vendimet e paarsyetuara për paraburgim.

**Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:**

- Të vazhdojnë të ofrojnë trajnime shtesë për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë dhe për gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, lidhur me arsyetimin e kërkesave dhe vendimeve për caktim të paraburgimit.
- Të vazhdojnë të ofrojnë trajnime shtesë për gjyqtarët dhe prokurorët për aplikimin e paraburgimit gjatë procedurës penale.
- Masat alternative ndaj paraburgimit gjatë rrjedhës së procedurës penale duhet të mbesin të arsimimit të vazhdueshëm ligjor të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**Për Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Prishtinës/Priştina:**

- Të sigurojnë se plan-programi inkorporon në mënyrë adekuate si ligjin vendor ashtu dhe atë ndërkombëtar, si dhe jurisprudencën që ka të bëjë me paraburgimin dhe të drejtën në liri.